

DHIMITËR S. SHUTERIQI

LETËRSIA SHQIPE E REALIZMIT SOCIALIST DREJT SUKSESESH TË REJA

Nga data 24-26 prill të këtij viti u mbajt në Tiranë Kongresi II i shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Në punimet e kongresit morën pjesë edhe shokët Enver Hoxha, Hysni Kapo, Manush Myftiu, Mehmet Shehu, Ramiz Alia e Rita Marko, kryetari i Kuvendit Popullor, Behar Shtylla, anëtarë të Komitetit Qëndror të Partisë, të Presidiumit të Kuvendit Popullor e të Qeverisë, përfaqësues të organizatave të masave etj.

Kongresin e deklaroi të hapur sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, Shefqet Musaraj.

Në emër të Komitetit drejtues të Lidhjes së shkrimtarëve dhe të artistëve, shoku Dhimitër S. Shuteriqi, kryetar i Lidhjes, mbajti raportin «Mbi gjendjen dhe detyrat e letërsisë dhe arteve tona».

Në hyrje të raportit shoku Dhimitër S. Shuteriqi paraqiti sukseset me të cilat u paraqitën në kongres shkrimtarët dhe artistët tanë, tregoi se, si rrjedhim i kujdesit të partisë, radhët e shkrimtarëve dhe artistëve janë shtuar me talente të reja, të cilat po plotësojnë kërkesat e kohës me vepra të mira të realizmit socialist. Pastaj shoku Dh. S. Shuteriqi foli mbi ngjarjet me rëndësi për fatet e njerëzimit e të socializmit për fatet e atdheut, që u zhvilluan qysh nga Kongresi I i shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, tregoi se si tradhëtia revizioniste çoi në degjenerim letërsinë dhe artin e sotëm sovjetik dhe vendeve të tjera ku erdhën në fuqi revizionistët. Në sajë të kujdesit të partisë dhe të mësimeve dritëdhënëse të shokut Enver Hoxha, tha raportuesi, letërsia dhe artet kanë ecur përpara, duke ruajtur pastërtinë ideologjike, janë vënë plotësisht në shërbim të çështjes së madhe të popullit e të partisë, të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste në vendin tonë.

Në pjesën e parë të raportit u analizua gjendja e letërsisë dhe e arteve tona në periudhën midis dy kongreseve.

Midis duartrokitjeve dhe brohoritjeve entusiaste, anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, Ramiz Alia, përshëndeti kongresin në emër të Komitetit Qendror të Partisë dhe personalisht të shokut Enver Hoxha.

Më poshtë po botojmë pjesë nga raporti i Kongresit II të shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë, mbajtur nga shoku Dhimitër. S. Shuteriqi.

GJENDJA NË LETËRSINË DHE ARTET TONA MIDIS DY
KONGRESEVE TË LIDHJES.

Në periudhën midis dy kongreseve të Lidhjes, letërsia dhe artet shqiptare të realizmit socialist kanë njohur një sërë suksesesh të shquara, që i kushtohen punës së vullnetshme të shkrimtarëve dhe artistëve tanë, besimit të tyre të plotë në çështjen e socializmit e në të ardhmen e atdheut, lidhjes së tyre të ngushtë me partinë e me interesat e popullit.

Ndihma dhe kujdesi i partisë kanë qenë të paçmueshme. Ato vazhdimisht janë rritur gjatë kësaj periudhe. Le të kujtojmë se ç'ndihmë e madhe që për letërsinë e artin tonë Vendimi i Komitetit Qendror i Majit 1961 dhe takimi ynë i korrikut të atij viti me udhëheqësin tonë të shtrenjtë, shokun Enver Hoxha, Plenumi XV i Komitetit Qendror i tetorit 1965 dhe kongresi V i Partisë. Tani së fundi, fjalimi i shokut Enver mbajtur në Konferencën XVII të oragnizatës së partisë të Tiranës, thelloi çështjet më të rëndësishme të jetës dhe të krijimtarisë sonë letrare dhe artistike, duke qenë kështu një kontribut i ri e i madh në përpunimin e mendimit estetik të partisë. Ky fjalim na çeli në mënyrë të gjerë perspektivat, duke përcaktuar një sërë detyrash themelore për të ardhmen, në pragun e kongresit që po mbajmë sot.

Në një kohë kur vala revizioniste rrëmbeu letërsinë e artet e Bashkimit Sovjetik e të disa demokracive popullore, kur njerëzit e letërsisë e të artit, në ato vende, në një pjesë të konsiderueshme u hodhën në anën e kundërrevolucionit dhe, më se një herë, e përgatitën këtë, — në këtë kohë, letërsia dhe arti shqiptar i realizmit socialist, shkrimtarët, kompozitorët, piktorët e skulptorët e Shqipërisë, pa harruar armatën e punonjësve tanë të tjerë në fushën e artit, mbajtën fort anën e revolucionit.

U provua kështu edhe një herë, gjatë ndeshjes së madhe të partisë sonë me tradhëtinë revizioniste, me imperializmin e borgjezinë ndërkombëtare, se vetëm një parti e shëndoshë e klasës punëtore, që bën një luftë konsekuente kundër artit të borgjezisë dhe ndikimit të tij mbi artin socialist, garanton zhvillimin e mbarë e të hovshëm të artit socialist. Kundër dëshirave të armiqtve tanë të klasës, borgjezë e revizionistë, realizmi socialist, ashtu siç e vinte re partia në Vendimin e Majit 1961, «e nxori letërsinë dhe artin shqiptar në një rrugë të gjerë zhvillimi». Letërsia dhe arte me një trashëgim shumë më të madh se i yni, me forca të mëdha krijuese, posa u mungoi udhëheqja marksiste-leniniste, nisën të bëhen bisht i dekadentizmit e i krijimtarisë reaksionare të borgjezisë.

Eksperienca e letërsisë dhe e artit shqiptar të realizmit socialist ka kështu domethënjen e vet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sukseset, — e po kështu edhe dobësitë e të metat, — e letërsisë e të artit tonë socialist gjatë këtyre 12 vjetëve, vazhdojnë të jenë kryesisht ato të një letërsie dhe arti ende të ri e në rritje. Me të drejtë ne çmojmë zhvillimin e tyre sasior e cilësor. Nuk është pa interes të përmendim se, kohët e fundit, botimet tona origjinale letrare janë më se dyfishuar.

Atë që ne e quanim «shenjë pjekurie» për letërsinë e artin tonë para kësaj dekade, sot mund ta çmojmë si një fenomen që ka marrë zgjerim. Aty mbështetet kërkesa e partisë për një hop të ri cilësor në këtë fushë.

Romane si «Këneta» (F. Gjata) dhe «Një vjeshtë me stuhi» (A. Abdihoxha) u çilnin rrugën veprave si «Lumi i vdekur» (J. Xoxa), «Para agi-

mit» (Sh. Musaraj), «Tradhëtia» (K. Resuli), «Dasma» (I. Kadare) etj., që romanin e përgjithësisht prozën shqipe e afirmuan fort këto vjet, pa harruar cilësitë e reja që ka fituar novelistika jonë gjatë së njëjtës kohë, me larinë e veprave dhe të talenteve. Futja e dramaturgjisë në fazën e një trajtimi më realist, përmes veprash si «Karnavalet e Korçës» (S. Çomora) e «Cuca e maleve» (L. Papa), «Doktor Aleks» (I. Uruçi) e «Mbi gërmadhat» (F. Paçrami), flet për atë përpjekje të përgjithshme të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë për thellimin e tendencës realiste, thellim që është një nga tiparet themelore të letërsisë dhe të artit tonë socialist në krahasim me paraluftën.

Shtrimi i problemeve shoqërore, ashpërsimi i luftës klasore, pasurimi i botës së brendshme të personazheve, natyra komplekse e marrëdhënjëve midis njerëzve, kanë gjetur trajtimin e tyre në prozën e pastaj edhe në dramën tonë. Pas Kongresit tonë të parë, realiteti kapet në pamje më të shumta, thellohen sidomos karakteret, elementet ideore dhe artistike shkrihen më mirë, ka një lidhje më organike midis problemeve të mëdha shoqërore që trajtohen dhe jetës vetiake të personazheve, vihet re një pathos më unik në veprat e arrira. Në vitet '60, shkrimtarët u përpoqën të sjellin material më të pasur nga jeta. Janë ngritur në prozën e dramaturgjinë tonë të këtyre viteve probleme të lidhura me ambientet patriarkale dhe mikroborgjeze, është përqëndruar vëmendja në botën shpirtërore të të rinjve, në marrëdhënjet e jetës familjare. Ky grumbullim përvoje dhe kërkesat e jetës sollën një përparim të dukshëm sidomos në prozë, ku tani kemi të bëjmë me dy tendenca kryesore: me prirjen për të pushtuar realitetin në tablo të gjera, në periudha të plota historike, dhe në prirjen tjetër, për të dhënë tablo sintetike me stil lapidar, ku mendimi filozofik e poetik lot rolin kryesor.

Një fillad i fortë nisi të fryjë në poezinë tonë të periudhës për të cilën po flasim, me përmbledhje poemash e vjershash si «Përse mendohen këto male» (I. Kadare), «Ringjallja» (Ll. Siliqi), «Devoll, Devoll» (D. Agolli), «Dhe thonë se paqe ka në botë» (A. Gjakova), «Alarme të përgjakura» (F. Arapi) etj. Tipari dallues i poezisë sonë, që të synojë pasqyrimin e novatores së jetës është rritur. Duke u bërë më e figurshme dhe me filozofike, poezia u largua mjaft nga një farë naracioni që disa herë e çonte në prozaizëm. Kontribut në pasurimin e letërsisë me tipa dhe ambiente kanë sjellë një varg poemash tregimtare. Po rezultatet më të shquara në thellimin realist të poezisë i arriti vjersha, me karakterin e saj liriko-epik, e kështu edhe poema e quajtur «poemë-sintezë».

Sikundër shihet, meritë themelore e letërsisë dhe e arteve tona, edhe të kësaj periudhe, është pasqyrimi përherë e më i gjerë i jetës aktuale të popullit, që nga Lufta nacionalçlirimtare dhe formimi i partisë e gjer në fazën e sotme të ndërtimit socialist, me problemet e mëdha të kësaj jete, me heronjtë e saj të rinj, me pathosin revolucionar të saj. Kështu letërsia dhe arti ynë është lidhur ngushtë me të gjitha përpjekjet e popullit tonë gjatë tri dekadëve të fundit.

Për të theksuar është se shkrimtarët e artistët kanë nisur të venë mirë në jetë parullën që hodhi partia në Kongresin e saj të pestë, për pasqyrimin flakë për flakë të realitetit. Kjo ngjau jo vetëm në gjinitë që e kanë përcjellë vazhdimisht jetën tonë të re me frymëzimet e tyre më spontane, si vjersha apo tregime, kënga apo grafika, por edhe në gati tërë gjinitë e tjera. Le të shënojmë këtu meritën e veçantë të të rinjve që sapo filluan të duken në jetën tonë letrare dhe artistike dhe

që janë, si të thuash, pjellë e vetë revolucionarizimit të vendit këto vjet. Le të shënojmë gjithashtu meritën e dramaturgëve, të cilët iu përgjigjën kërkesës së partisë për revolucionarizimin e skenës, duke i marrë temat nga ngjarjet e kohës, nga lufta për emancipimin e gruas dhe kundër paragjykimeve të ndryshme shoqërore, ose bëmat e heronjve të ditës, që nga Adem Reka e Shkurte Vata, gjer te Ismet Sali Bruçaj. Këta u bënë heronj edhe të më se një vepre artistike, si në këngë e poezi të shumta, në krijime të pikturës, skulpturës, grafikës etj.

Shquajti kështu menjëherë efekti revolucionarizues i temës së ditës mbi letërsinë e artin. Njerëzit tanë të letërsisë e të artit filluan të jetojnë me një puls edhe më dinamik pranë popullit, t'i ndjekin në mënyrë më aktive problemet e kërkesat e masave, të ndjejnë më thellë dinamizmin e jetës sonë socialiste dhe ta bëjnë atë vetë pulsën e krijimtarisë. Ky hov solli gjëra të reja jo vetëm në revolucionarizimin e jetës letrare dhe artistike, si edhe në konceptet mbi punën krijuese, por ai ka nisur të sjellë gjëra të reja edhe në trajtimin e vetë llojeve dhe të gjinive, si, bie fjala, me zhvillimin e dramës dokumentare dhe të romanit të shkurtër.

Letërsia dhe artet tona lëruan gjatë kësaj kohe edhe temën historike dhe atë ndërkombëtare, të cilat zënë një vend të merituar në krijimtarinë tonë. Tema e historisë së djeshme e më të largët të jetës së popullit tonë ka fituar shpesh një tingull të fortë aktual, përmes kuptimit marksist-leninist të fakteve dhe të ngjarjeve, të rolit të masave dhe të heronjve në to. Tema ndërkombëtare, veçanërisht e dashur për poezinë dhe grafikën tonë, ka pasqyruar mirë luftën kundër imperializmit që bëjnë popujt e ndryshëm në të katër kontinentet, p.sh. luftën e popujve të Vietnamit e të botës arabe, si dhe luftën kundër revizionizmit. Është theksuar kështu karakteri internacionalist, që vazhdimisht e ka dalluar letërsinë dhe artin tonë të ri.

Rritja e gjithanshme e krijimtarisë letrare dhe artistike, kualifikimi përditë e më i madh i saj, ka bërë që individualitetet artistike të shtohen e të theksohen. Realizmi socialist provoi kështu mundësitë e tij të pakufishme për zhvillimin e talenteve më të ndryshme, për larminë e stileve etj.

Letërsia dhe arti ynë janë bërë kështu një faktor përditë e më efikas për formimin e njeriut të ri. «Në punën e madhe që bën Partia për edukimin komunist të masave, — thuhej në Vendimin e Komitetit Qendror të Majit 1961, — shkrimtarët e artistët kanë qenë një mbështetje e fortë». Ata, tha shoku Enver dhjetorin e kaluar, «kanë edukuar një brez të tërë».

Duke përqaftuar idealet komuniste, duke mbështetur me gjithë forcën e tyre interesat kombëtare e ndërkombëtare të atdheut socialist, shkrimtarët e artistët kanë futur në veprat e tyre patosin e madh revolucionar të atyre idealeve të vëna në jetë. Ata kanë ushqyer e rritur në masat besimin se atdheu ynë i vogël do t'u bëjë ballë, si ç'u bëri ballë vërtet, valëve që mund t'i sjellë historia, besimin në udhëheqjen e drejtë e të sigurtë të partisë, besimin në fitoren përfundimtare të socializmit. Për edukimin e njeriut të ri me frymën e luftës klasore, kundër çdo mbeturine borgjeze dhe patriarkale në botëkuptimin e në marrëdhënjet midis njerëzve, për triumfin e pandërprerë të së resë e për zbulimin e kësaj së reje, për rrënjosjen e frymës së kolektivit e të solidaritetit socialist, të qëndrimit ndaj punës e pronës së përbashkët, letërsia dhe artet tona kanë dhënë një kontribut ngaditë e më të dukshëm. Për këtë,

ato kanë bërë përpjekje për krijimin e figurës artistike të heronjve të epokës sonë.

Ne kemi krijuar një letërsi dhe art të shëndoshë të një pastërtie të madhe ideologjike. Kjo është, pa dyshim, fitorja më e rëndësishme e shkrimtarëve dhe artistëve edhe gjatë periudhës midis dy kongreseve të Lidhjes, kur ndeshja me ideologjinë borgjeze dhe revizioniste u ashpërsua shumë. Ne kemi krijuar një letërsi dhe art me një përmbajtje vërtet të pasur e me një karakter njohës të tillë, që e kanë rritur rolin e tyre në zhvillimin e kulturës sonë socialiste.

* * *

Me gjithë rezultatet e çmuara të tyre, letërsia dhe arti ynë kanë dobësi dhe të meta të ndryshme. Këto janë kryesisht dobësitë e të metat e një letërsie dhe arti që sapo marrin udhën e zhvillimit të tyre të gjerë, me kuadro relativisht të paka, sidomos në disa sektorë e gjini.

Ato të meta dhe dobësi, ne i vëmë re sot në pasqyrimin e pamjaftueshëm të realitetit tonë socialist, me tërë gjerësinë e thellësinë e duhur, në kapjen e pamjaftueshme të problemeve të ndërtimit socialist, në pasqyrimin ende të pakë të fenomeneve që i këmbyen faqen atdheut gjatë këtij çerek shekulli, si industrializimi i vendit e krijimi i një klase të madhe punëtoresh, kolektivizimi i bujqësisë, ndërtimi i kulturës socialiste, në paraqitjen shpesh në mënyrë të cekët të luftës klasore. Ato të meta dhe dobësi vihen re në trajtimin ende të pamjaftueshëm të rolit të partisë e të komunistit, të rolit të klasës punëtoresh e të masave në zhvillimin e jetës së vendit e në revolucionarizimin e saj. Ato pasqyrohen edhe në nivelin e ulët artistik të një numri veprash, ndonse niveli i përgjithshëm i letërsisë dhe i artit tonë u rrit në mënyrë të ndieshme gjatë kësaj dekade. Ne nuk kemi bërë gjithë përpjekjen, që jo vetëm në përmbajtjen, por edhe në mjetet e tyre të shprehjes, letërsia dhe arti të fitojnë më shumë cilësi e të bëhen gjithashtu më të kapshme nga masat, t'u përgjigjen më mirë shijeve publike dhe t'i shpien këto përpara.

LETËRSIA DHE ARTET DUHET TË VIHEN NË RADHËT E PARA TË LUFTËS PËR THELLIMIN E REVOLUCIONIT IDEOLOGJIK E KULTURAL.

Atdheu ynë ka hyrë në fazën e ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste. Fitoret ekonomike dhe politike kanë vënë në plan të parë nevojën e thellimit të mëtejshëm e më të shpejtë të revolucionit tonë ideologjik e kultural, thellim pa të cilin nuk mund të kryhet ndërtimi i plotë i socializmit, ku letërsia dhe arti luajnë një rol të rëndësishëm. Është e domosdoshme sot që, për t'iu përshtatur plotësisht bazës ekonomike të socializmit, superstruktura jonë të pastrohët nga çdo gjë e vjetër dhe e huaj që gjendet akoma në të. Është e domosdoshme që njeriu, si faktor vendimtar i ndërtimit të shoqërisë së re, i së ardhmes, të revolucionarizojë edhe më tej ndërgjegjen e botkuptimin e tij.

... Letërsia dhe artet, si pjesë e superstrukturës, janë dyfish të interesuara në këtë proces të madh revolucionarizimi, qoftë se duhet të bëjnë edhe ato një hop të ri cilësor, qoftë se duhet të rritin rolin në shoqëri. Po nuk bënë të parën, ato s'mund të bëjnë as të dytën. Duke revolucionarizuar

rizuar vetveten, letërsia dhe artet do të mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në revolucionarizimin e jetës.

...Detyra e letërsisë dhe e arteve tona sot, detyra e çdo shkrimtari dhe artisti është që të vihen në radhët e para të luftës për thellimin e revolucionit ideologjik e kultural, të luftës për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste.

1. Të ruajmë e të zhvillojmë frymën e partishmërisë komuniste, që shquan krijimtarinë tonë letrare dhe artistike.

Ne kemi krijuar një letërsi dhe art që ka në themel ideologjinë marksiste-leniniste dhe që i nënështrohet në mënyrë të ndërgjegjshme dhe aktive politikës së partisë. Shkrimtari dhe artisti ynë, në pasqyrimin e realitetit, lufton për një qëndrim materialist shkencor dhe klasor revolucionar, i bindur se kështu zbulon të vërtetën e jetës dhe e bën këtë të vërtetë një armë në duart e masave në luftën për ndërtimin e socializmit.

Kjo frymë partishmërie, thelbësore e realizmit socialist, është edhe parimi themelor i metodës sonë krijuese. Pra, në rrugën e thellimit të revolucionit tonë ideologjik e kultural, detyra themelore e letërsisë dhe e artit është që ta ruajmë e ta zhvillojmë frymën e partishmërisë komuniste që ato i shquan. Kjo partishmëri është siguruar e është rritur përmes luftës së pandërprerë, që ka udhëhequr Partia edhe në fushën e letërsisë e të artit, kundër ndikimit të ideologjisë borgjeze e revizioniste.

Arti është një fushë e luftës së klasave. «Kjo luftë, — thotë shoku Enver — është shprehja e luftës midis ideologjisë proletare dhe ideologjisë borgjeze, midis realizmit socialist dhe rrymave artistike reaksionare borgjeze që në mënyra të ndryshme ushtrojnë presion mbi njerëzit tanë». Çështja është se sa ne, si shkrimtarë e artistë dhe si organizatë që drejton punën tonë krijuese, jemi të ndërgjegjshëm të kësaj lufte klasore dhe sa hidhemi në të. Të mos harrojmë për asnjë çast se lufta klasore ka vështirësi të shumta gjatë ndërtimit socialist, njeh zikzake dhe shpesh acarohet, kurse partia e drejton atë në favor të socializmit.

Ai indiferentizëm e liberalizëm, që nganjëherë haset në mes tonë e që partia e ka kritikuar me kohë, nuk përkon me qëndrimin klasor revolucionar të njeriut e të artit tonë të ri. Në kuadrin e thellimit të revolucionit ideologjik e kultural, kur letërsia dhe artet duhet të jenë në radhët e para të luftës, ne vëmë re se ato nuk po e lozin ende sa duhet këtë rol. Vërtet në fushën e ideologjisë e veçanërisht të artit, kthesat nuk bëhen lehtë; ndërgjegjja shoqërore mbetet pas qënjes shoqërore. Po tamm për këtë, edhe presioni i ideologjisë së huaj këtu gjen një shesh jo të vogël veprimi, prandaj këtu duhet ta bëjmë edhe më të fortë luftën, ta mprehim edhe më shumë vigjilencën.

Le të marrim një shembull. Sot, pjesa më e madhe e shkrimtarëve dhe artistëve e ka përqafular parullën e partisë, që t'u përgjigjet flakë për flakë kërkesave të pasqyrimin të realitetit. Ne jemi të bindur se jubileu i 25-vjetorit të çlirimit ka për të qenë një faktor i madh për të ndihmuar revolucionarizimin në këtë drejtim të veprimtarisë sonë krijuese. Por akoma nxjerr aty-këtu krye teoria e «distancës» që ekzagjeron faktin se fenomenet shoqërore jo vetëm duan një farë kohe që të kristalizohen, por edhe që të kapen nga artisti. Thuhet se «letërsia dhe arti nuk janë

si politika, që t'u përgjigjen flakë për flakë problemeve të kohës», se «arti profesionist nuk mund t'i përgjigjet aktualitetit si arti amator» etj. Po ku qëndron ahëre tipari dallues i realizmit socialist, që ta pasqyrojë realitetin në zhvillimin e tij revolucionar, duke zbuluar të renë posa ajo lind e duke vënë atë në pah, si një fenomen që ka të ardhmen e për të cilin duhet luftuar? Jo vetëm kaq, por duke ndjekur tendencat përparimtare të jetës e duke hyrë thellë në rrjedhën e saj, arti vështron në të ardhmen e mund të parashikojë në të. Në se këtë e bënte diçka arti i së kaluarës, që kishte në bazë një koncept idealist të jetës, arti ynë, që ka në bazë konceptin materialist-dialektik, d.m.th. një koncept të saktë shkencor, këtë mundet e i kërkohet ta bëjë shumë më mirë.

Zbatimi i parullës që letërsia dhe arti t'i përgjigjen flakë për flakë realitetit, supozon atë gatishmëri revolucionare që fiton artisti, kur ai jeton në mënyrë aktive në shoqëri, kur ai, me pasion krijues, e ndjek rrjedhën e fenomeneve, kur ai kupton thellë se roli i artit është tamam në radhët e para të luftës për revolucionin ideologjik e kultural.

Misioni i artit është aq i rëndësishëm sa edhe delikat. Arti dhe letërsia jonë duhet të ndihmojnë në mënyrë edhe më efikase, edhe më të fortë, për kalitjen e njeriut të ri. Zbrazëtirat e gabimet ideologjike, që janë pengesë për zhvillimin revolucionar të krijimtarisë, bëhen mjet infektimi për masat e popullit, në të cilat i përhap libri, kënga, piktura etj. Estetika idealiste dhe reaksionare, që minimizon ose mohon rolin edukues të artit, borgjezia që i ndjek me mënyrat e saj të dhunës së hapur ose të fshehur veprat e artistët revolucionarë, revizionistët, që aq mirë e njohin rolin edukues të artit, sa janë duke e përdorë me të madhe për degjenerimin e rinisë e për luftën kundër socializmit, më kot përpiqen ta cilësojnë artin e realizmit socialist si «moralizues e të thatë».

Ne që e çmojmë karakterin militant të artit, e çmojmë tamam e kryesisht për këtë, sepse duke edukuar e kalitur njeriun e ri, ai kontribuon në ndërtimin e socializmit. Dhe ne e dimë se ky karakter edukues rrjedh nga vetë karakteri njohës i artit. Arti ynë nuk i ushqen njerëzit me ideale të vjetra dhe iluzione utopike, nuk i mashtron ata, por i lidh me idealet konkrete të ndërtimit të një të ardhmeje më të mirë njerëzore, duke u bërë thirrje e duke i mësuar të luftojnë për këtë. Ja arsyeja përse borgjezët e revizionistët i bashkon lufta kundër realizmit socialist, shprehje e vetë luftës kundër socializmit. Kujdesin që kanë partitë marksiste-leniniste për ruajtjen e pastërtisë së Artit dhe ngritjen ideologjike të tij e të artistëve, armiqtë tanë të klasave përpiqen ta paraqesin si «një vijë shtrënguese, imponuese, mbytëse të mendimit të lirë krijues». Por, si thotë shoku Enver, «ne marksistë-leninistët zhvillojmë në të gjitha drejtimet luftën tonë klasore proletare, për të çliruar, zhvilluar, për të bërë që të përparojë me hapa vigane mendimi krijues dhe jo për të frenuar e për ta shtypur atë». Këtë ne e bëjmë kundër çdo mbeturine dhe presioni të ideologjisë idealiste dhe reaksionare të borgjezisë e të revizionizmit, që përpiqen me çdo mjet ta mbajnë skllav mendimin krijues.

* * *

Ne kemi pasur raste, kur ndikimi i ideologjisë borgjeze dhe revizioniste, në mënyrë ku më pak e ku më shumë të theksuar, është manifestuar në krijimtarinë letrare dhe artistike, sidomos në fillim të viteve

'60. Vigjilenca jonë si autorë e si kolektiv, vigjilenca e kritikës dhe e institucioneve artistike, nuk ka qenë disa herë në lartësinë e duhur. Qëndrimet liberale që kemi treguar me botimin, vënjen në skenë etj. të veprave me të meta të rënda ideologjike ose që ishin në themel në pozita antirealiste e revizioniste, na kanë dëmtuar.

Duke stigmatizuar atë «iracionalizëm të pakufishëm», që sot mbretëron në letërsinë dhe artin dekadent, letërsi dhe art të cilin borgjezia kërkon «ta ngrejë në model», e «simbol», shoku Enver na fton «të jemi vigjilentë nga kurthet që ngre armiku i klasës, si brenda ashtu edhe jashtë», të mos harrojmë fjalën e popullit, se «çdo gjë që ndrit nuk është ar».

Një dramë si «Partizani pa emër» (F. Arapi) kërkonte «të militojë për thellimin realist» e «të luftojë shabllonin» e veprave ku heronjtë që kemi simpatizuar nga jeta paraqiten «vetëm trima». Dhe në dramë, protagonistë u bënë frikamanët, — skenë, ku ata topiteshin, u bë një ferrë! Përse mund të manifestonte kjo vepër, në mos për çheroizmin e heroit, për të cilin bëhet aq shumë nga estetika dhe arti revizionist? Prej «skematizmit» me të cilin njollosen shpesh heronjtë e shëndoshë të realizmit socialist, u kalua në skematizmin e vërtetë të «heronjve nga halli». Konkluzioni logjik do të ishte romani «Tuneli» (Dh. Xhuvani), ku njeriu i sakrificës nuk ishte më personazhi i pararojës, po një fatkeq, i cili, në një kantier socialist, gëzimin e jetës nuk e gjen te puna e përbashkët e ndërtonjësve, po te dashuria, edhe kjo incest. Ishte një shpifje kundër realitetit, një shtrembërim i vetive të mëdha të vetëmohimit që frymëzojnë njerëzit tanë. Kantieret socialiste a mos janë vallë të tilla? «Të tilla janë», pohonte drama «Rrethi i bardhë» (N. Priftit), ku solidaritetit socialist ia zinte vendin urrejtja mikroborgjeze dhe «izolimi» i dëshpëruar në një «natyrë armike».

Ndërsa në dramën «Dueli» (Q. Buxheli) armiku nazist paraqitej «i arësyeshëm» dhe te versioni i parë i romanit «Gjenerali i ushtrisë së vdekur» (I. Kadare), oficeri madhor fashist nuk dilte njeri i keq, në romanin «Qyteti i fundit» (P. Marko) një oficer i porsadalë nga Lufta nacionalçlirimtare «inamorohej» me një lavire italiane, «i gjalli me të vdekurin», si në novelën e errët «Simfoni e pambaruar» (S. Spasse), ku një grua, për t'i nderitur besnike burrit të zemrës, lidhte me të «martesën postume»!

Në këto raste, apo dhe në ato të disa tregimeve të përmbledhjes «Zhurma e erërave të dikurshme» (D. Agolli), ne hasnim ndikimin e drejt-përdrejtë të letrarëve revizionistë për «ta zgjeruar cakun e realizmit», «zgjerim» që bëhej nga njëra anë me shëmtimin e jetës e të heronjve tanë, kurse, nga ana tjetër, me zbulimin e armikut, ose mëshirimin e tij, kur nuk kishim një qëndrim antirealist gati mistik. Këto s'ishin gjë tjetër, veçse shfaqje të objektivizmit mbiklasor e të humanizmit të vjetër abstrakt, të cilin revizionistët e servirin si diçka «të re». Për autorë realistë, si autorët tanë, këto ishin shfaqje të diçkaje të huaj, që ata s'e kishin shkukur me rrënjë nga ndërgjegja dhe vazhda e tyre krijuese dhe që u manifestua nën presionin e ideologjisë së huaj.

Fakti që tani raste të tilla i hasim shumë më rrallë, tregon se vigjilenca jonë është rritur. Porse ne s'kemi asnjë arsye që ta dobësojmë atë. Përkundrazi, në atmosferën revolucionare që krijoi Kongresi V i partisë, duhet të rritim e të mprehim luftën klasore në fushën e letërsisë e të artit.

2. Të pasqyrojmë më gjërë e më thellë aktualitetin socialist

Problemi i pasqyrimin të realitetit është problemi kyç i zhvillimit të artit, dhe, kur flasim për letërsinë e artin tonë, mund të themi plot gojën se është përmbatja e re që depërtoi në të, pasqyrimi i aktualitetit socialist, që solli edhe zhvillimin e shpejtë e të gjithanshëm. Po fakti është se, me gjithë përpjekjet që kemi bërë për pasqyrimin e aktualitetit tonë të më se një çerek shekulli, ato përpjekje duhen shtuar shumë.

Është çështja që t'i japin rrugë sa më të shpejtë kërkesës për një letërsi dhe art që t'i përgjigjen gjerësisht e në mënyrë më të thellë aktualitetit socialist shqiptar. Kjo është një tjetër detyrë e jona e madhe në rrugën e revolucionarizimit të krijimtarisë letrare dhe artistike.

Kjo është së pari një çështje e orientimit tematik.

Le të bëjmë pyetjen: sa do të pasurohet gjithë letërsia dhe arti ynë me botëkuptimin proletar e me përmbajtjen militante klasore, me ç'ka sot më të përparuar e më revolucionare në jetën e atdheut, po të vazhdojë tema e punës e përgjithësisht tema e jetës së klasës punëtore të trajtohet në mënyrë ende të kufizuar në to?

Mungesat që kemi në trajtimin e kësaj teme, shpjegohen, ndër të tjera, me mobilizimin e pamjaftueshëm të secilit e të ne të gjithëve, për të njohur nga pranë jetën e klasës pararojë, që duhet t'i japë vulën e saj gjithë veprimtarisë shoqërore, pra edhe artit e letërsisë. Ajo shpjegohet me një farë inercie dhe mos inisiative, në një vend ku klasa punëtore është e re dhe ku letërsia dhe arti kanë pasur për traditë të pasqyrojnë kryesisht jetën e mikroborgjezisë së fshatit e të qytetit.

Te kjo lloj inercie e gjen shpjegimin mendimi konservator, sipas të cilit «është e zorshme të pasqyrosh në art jetën e klasës punëtore». Po, sigurisht, e lehtë s'është, sidomos në rrethanat që përmendëm. Veçse kjo pikëpamje skeptike nuk pajtohet me detyrën e revolucionarizimit të shpejtë të krijimtarisë sonë letrare dhe artistike, në kuadrin e thellimit të revolucionit ideologjik e kultural. Nuk ishte lehtë për popullin tonë të çajë rrethim pas rrethimi, blokadë pas blokade, dhe të ndërtojë ekonominë e tij të përparuar socialiste ku industria qëndron në ballë. Po lumit i delet me not.

Tema e klasës punëtore, temë qëndrore për artin socialist, duhet të bëhet kudhra e madhe në të cilën të farkohet çeliku i artit tonë, që të kalitet vërtet. Gjer tani, ne kemi qenë pak. Edhe tani s'jemi akoma shumë. Po që t'ia hyjmë kësaj detyrë në mënyrë frontale, s'jemi pak dhe përvoja, ende e pamjaftueshme, në këtë përpjekje do të pasurohet e do të piqet.

Shumë drejt është pohuar se në letërsinë e artin tonë duhet të hyjnë shprehitë që krijon realiteti socialist. Kjo është një domosdo dhe këtu jemi mangët. Po si më mirë do të hyjnë aty këto shprehje, veçse përmes jetës që gumëzhin në uzinat e kantieret tona. Ku më i lartë botëkuptimi proletar, ku më i pasur në vetitja e përgjegjësisë e të vetmohimit, të optimizimit e të perspektivës? Një meritë e romanit «Dasma» është se përpiqet t'i pasqyrojë gjerë këto shprehje. Një dramë si «Ngjarje në fabrikë» (F. Paçrami) ka meritën të na paraqesë ngritjen e ndërgjegjes së kolektivitetit punëtor, i cili spastron radhët e kalit veten, përmes ushtrimit të kontrollit të vet të klasës.

Transformimet që janë bërë në jetën e fshatit tonë janë të mahnitshme. Myzeqeja, së cilës J. Xoxa i skaliti portretin e saj të djeshëm, dëshmon lart për këtë. Po s'e kemi portretin e plotë të Myzeqesë apo Zadrimës, të Dumresë apo Vurgut socialist. Pak është shkruar, veçanërisht në prozë, për hovin revolucionar me të cilin malësitë e përqaftuan tre vjet më parë kooperimin. Kjo ishte një ngjarje e papërsëritshme në madhësinë e saj. Te thirrja e partisë për kooperim, malësia gjente provat e mëdha që ka dhënë vija e drejtë marksiste-leniniste e partisë për kolektivizimin e fushave dhe të viseve kodrinore, gjente sigurinë e një baze të fortë socialiste tanimë të krijuar në bujqësinë shqiptare, bazë që do t'i shërbente si një mbështetje e fortë për t'u hedhur në të ardhmen. Besimi dhe gatishmëria në fjalën e partisë, që vihet re në gjithë sektorët e veprimtarisë shoqërore, është një nga tiparet proletare që ka fituar edhe fshatarësia. Një roman si «Ara në mal» (P. Marko) ka dhënë, këto kohët e fundit, një pamje realiste të këtyre fenomeneve, duke i lidhur ato edhe me fenomene të tjera të jetës, si p.sh., me luftën për emancipimin e gruas. Por ne të gjithë e ndjejmë se sa në borxh gjendet letërsia dhe arti ynë për të pasqyruar realitetin e ri të fshatit shqiptar të kolektivizuar.

Lufta kundër fesë dhe zakoneve prapanike, lufta për emancipimin e gruas solli gjëra të reja në krijimtarinë tonë dhe kjo tregoi se arti fiton shumë gjatë fushatave, po ta marrim këtë fjalë me kuptimin e aksioneve të pandërprera revolucionare. Atmosfera e revolucionarizimit të jetës hyn kështu në praktikën artistike. Të bën përshtypje nga diskutimi mbi pasqyrimin e emancipimit të gruas në letërsi, se gratë vetë nuk janë të kënaqura me trajtimin sadokudo të ngushtë me të cilin proza jonë rrahu temën, duke mos vënë në plan të parë gruan që është hedhur vetë në ballë të Luftës, kurse dramaturgjia përkundrazi, e ka bërë këtë (p.sh. veprat e Z. Cikulit, I. Uruçit).

Temë nga më të dashurat e më të kërkuarat nga masat e popullit e veçanërisht nga rinia, që ruan një aktualitet të plotë e një forcë të madhe edukuese, është për ne tema e epopesë së Luftës nacionalçlirimtare. Te kjo temë, letërsia dhe arti ynë janë kthyer gjithmonë me dëshirë e me rezultate të mira. Ato në të ardhmen duhet të bëjnë edhe më mirë. Në këtë përvjetor të lavdishëm të çlirimit, shkrimtarët e artistët tanë kanë për të dhënë një kontribut të ri në trajtimin e temës së Luftës heroike nacionalçlirimtare, që i çeli rrugën socializmit në Shqipëri.

Arti ka luftuar kurdoherë me forcën e shembullit. Arti i epokave të kaluara ka përdorë zakonisht forcën e shembullit negativ, por ai ka përdorë edhe atë të shembullit pozitiv, duke gdhendur heronj si Prometheu, heroina si Zhan d'Arka që i ndërtoi me fuqinë e vet të imagjinatës apo që historia i pati pjellë në dhëmbkat e saj. I tillë hero u bë me kohë për letërsinë e artin shqiptar Skënderbeu.

Arti i epokës sonë, arti socialist, lufton edhe me formën e shembullit negativ, për të dërmuar të vjetrën, porse ai lufton sidomos e në radhë të parë në forcën e shembullit pozitiv, për të treguar se si ngrihet vigane e reja që dërmon të vjetrën, si përgatitet e bëhet revolucion, zhduket prona private e ndërtohet socializmi, se si nga errësirat e mëdha të asaj «parahistorie», — si ç'i quante Engelsi epokat e shtjelluara gjer në socializëm — lind dita e «historisë» me epokën tonë, e cila shënon triumfin e shkencës mbi obskurantizmin, të njeriut që theu tërë prangat shoqërore mbi shoqërinë e prangave të skllavopronarëve të çdo lloji e

të më të egërve prej tyre, kapitalistëve. Tani fjala njeri tingëlloi me tërë kuptimin — e revolucionarit, të militantit të paepur, të ndërtonjësit të së ardhmes.

Letërsia dhe arti ynë krijuan heronj të vërtetë të idealit revolucionar e komunist. Po ne kemi bërë ende pak. Na mungon mjaft e në radhë të parë heroi komunist, protagonist i ndritur i jetës sonë në poliedritetin e personalitetit të tij, komunisti i fabrikës, komunisti i kooperativës, punëtori i partisë, që natën e bën ditë. Sekretarët e partisë akoma disa herë në veprat tona janë sa për të sjellë aty një notë partishmërie, në mos për të shpejtuar e zgjidhur ndonjë situatë të ndërë. Sa kohë trajtojmë temat e Luftës nacionalçlirimtare, me konfliktet e ashpëra antagonistë, heronjtë komunistë janë në krye të situatave, si partizanë apo ilegalë, si komandantë apo komisarë politikë. Kështu edhe në veprat ku paraqitet ndeshja që vazhdoi në vendin tonë me armiqtë edhe pas çlirimit. Po protagonistë si Qemal Orhanajt, Arben Preshevat e Stavri Larat, i gjejmë më pak në veprat ku trajtohen situatat e komplikuara të konflikteve joantagoniste, që u bënë ditaditës më tipike për shoqërinë tonë të pasluftës. Kujtoni personazhet e zbetë pozitivë të ndonjë veprë të fundit, si «Fytyra e dytë» (D. Agolli) etj. Në letërsi dhe në art gjejmë pak heronj që do të mateshin me Liza Ramat e Nuredin Hoxhat e jetës.

Le të shënojmë këtu, se tepërimi që është vënë re në repertoret tona me pjesë mbi heronjtë e rënë, me një trajtim disa herë thjesht biografik, — ushqen tek spektatori, dashje padashje, një ndjenjë trishtimi. Le të shënojmë gjithashtu se hasim keqkuptime në pasqyrimin e temës së heroit masiv. Ka raste kur lidhjet e heroit me masën shihen në mënyrë të sipërfaqshme dhe kujtohet se heroizmi kolektiv mund të dalë duke sjellë në skenën e teatrit apo të operas një masë amorfë.

Akoma bëhen diskutime për çështjen në se heroi pozitiv duhet të jetë me ose pa të meta. Nga njëra anë, në emër të një realizmi të kuptuar ngushtë, nuk konceptohet dot që, në art, njeriu të mund të paraqitet i përsosur. Kjo pikëpamje nënvleftëson rolin edukativ të personazhit pozitiv, duke i mohuar gjithashtu artit të drejtën që realitetin ta japë në mënyrat më të ndryshme. Nga ana tjetër, duke u nisur nga kërkesa jo realiste, arrihet në idealizim, personazhet pozitivë paraqiten pllakateskë, ata triumfojnë jo përmes luftës së ashpër e të ndërlikuar, po si prej çudie.

* * *

Detyrë themelore për artin socialist është që të pasqyrojë me vërtetësi realitetin. Partia jonë kurdoherë e ka shtruar me forcë këtë çështje, qoftë duke kërkuar një art më të thellë në përmbajtje, qoftë duke luftuar atë subjektivizëm që shfaqet në veprat tona, kur ne nuk e njohim realitetin, kur e llustrojmë ose e nxijmë atë, gjë që e vuri përsëri në dukje shoku Enver, në fjalimin e tij të dhjetorit të kaluar, kur tha se, «në krijimet letrare, ne shpesh gjejmë më shumë refleksin e botës së brendshme të autorit dhe më pak jetën e gjallë, luftarake, revolucionare të masave punonjëse, të atyre që punojnë e veprojnë».

Problemi i thellimit realist të artit është problem i trajtimit të konflikteve klasore, antagonistë dhe joantagoniste, me vërtetësinë e forcën që ato paraqiten në jetë. Adem Rekat e Shkurte Vatit mbeten sigurisht të pavdekshëm për sakrificën e tyre supreme, po, në se e kqyrim së afërmi jetën e tyre, në vazhden e përditshme të saj, do të zbulojmë se

kulmi sublim nuk qe një mbarim i rastësishëm, porse shprehja e fundit e një rritje të përditshme të heroit, i cili kontributin e tij e bashkoi me forcat e reja në zhvillim, duke u ndeshur me forcat e vjetra që duhen kapërcyer apo zhdukur. Ajo sakrificë ishte shprehja e fundit e gatishmërisë dhe vetëmohimit që kërkon socializmi, si kur duhet të ruajmë bigën në furtunë, si kur duhet të rendim në hekurudhë në ballë të cucave ende të ndrojtura.

Nuk është skematike jeta, porse del skematika në art, kur aty jepet cekët. Për këtë bëhet pengesë jo vetëm mosnjohja e jetës, por edhe mungesa e guximit krijues, i cili nuk vjen përherë nga mosnjohja e jetës. Nuk mund të rrimë pa përmundur, se ndonjë drejtor teatri ose estrade, redaktor ose punonjës i kulturës, kënaqet me veprat tona, kur ato dallohen për zbehjen, në mos edhe për shmangjen e konflikteve klasore, dhe vë hall të tepëruar nga ato vepra që me guxim i rrokin e i paraqesin ato konflikte, të cilat ai nuk do të nguronte t'i zbejë. Kjo është mënyra më komode e të akomoduarit me artin «banal e pa ide», me një art që nuk e qas partia dhe që burimin s'e ka te jeta, po te dëshirat e kërkesat subjektive, të cilat lindin nga drojtja prej paraqitjes realiste të konflikteve jetësore në art. Kjo është një mënyrë drejtimi artistik «pa telashe», që nga arti nuk kërkon guxim, siç kërkohet edhe në çdo fushë të jetës, pra nuk kërkon një revolucionarizim të vërtetë. Le të shohim se si paraqitet problemi në një fushë delikate si ajo e satirës.

Thelbësore për satirën është të mohojë të vjetrën për të pohuar të renë. Në sistemet e kaluara shoqërore, satira, duke mohuar të vjetrën, mohonte vetë sistemin, i cili duhej këmbyer, duhej përmbysur. Në socializëm satira, me anë të gazit, ndihmon që të shporret nga skena diçka që në shoqëri ka qëndruar tepër e dëmton, duke u bërë kështu arti aleat i shoqërisë, duke pasur kështu satira një rol thellësisht pozitiv. Po satira mund të lozë rol negativ në shoqërinë tonë, në se, ashtu siç bën shpesh satira e vjetër, të keqen e paraqit si diçka që njerëzimi e ka në natyrën e vet dhe s'mund ta kapërcejë as në socializëm, apo në se përpiqet ta bëjë të bardhën të zezë, duke shpifur, për të hedhur dyshimin mbi të renë, për ta diskredituar atë. Kjo është një satirë antisocialiste, është tamam satira e sotme e revizionistëve.

Vështrësia e veçantë e punës së artit socialist dhe sidomos e satirës, qëndron në trajtimin e kontradiktave të tipit joantagonist, domethënë të kontradiktave në gjirin e popullit, aq tipike të shoqërisë pa klasa antagonist. Këto, artisti duhet të dijë t'i dallojë prej kontradiktave të tipit antagonist, domethënë të kontradiktave midis nesh e armiqve tanë. Ngatërrimi i tyre në art, nga njëra anë, na shpie të acarojmë konfliktet në gjirin e popullit, pra të biem në gabime sektare, kurse, nga ana tjetër, të zbusim konfliktet midis nesh e armiqve tanë, pra të biem në gabime oportuniste. Këto gabime mund t'i bëjmë në çdo fushë të artit, sepse artit, zakonisht, nuk i mungon qëndrimi kritik klasor. Ato gabime mund t'i bëjmë si shkrimtarë e artistë të çdo gjinie, si kritikë e ekzekutues, interpretues e drejtues artistikë. Dhe kjo nuk evitohet me zbutjen e konflikteve apo me ilustrimin e jetës, që e dobëson artin dhe e humb vlerën njohëse dhe edukuese të tij, po me paraqitjen realiste dhe në frymën marksiste-leniniste të konflikteve të jetës në art, gjë që kërkon guxim, po që është rruga e forcimit dhe e revolucionarizimit të artit, e shtimit të vlerës së tij njohëse dhe edukuese.

Në se do t'i japim personazhet tanë pozitivë me tërë vërtetësinë dhe forcën revolucionare që i karakterizon ata në jetë, në se do t'i paraqitim

në luftën e fortë klasore që bëjnë kundër së vjetrës e për triumfin e së resë, ne patjetër do t'i trajtojmë thellë konfliktet e jetës në art, do t'i zgjidhim ato drejt e me guxim. Kjo do të ngjasë edhe kur t'i hiperbolizojmë ato, sikundër mund ta kërkojë arti.

Pohimi i së resë në art duhet pra të tingëllojë me gjithë forcën që tingëllon në jetë, përmes ngritjes së të resë, të revolucionares, përmes shembjes së të vjetrës. Kështu heronjtë e veprave tona, heronjtë që mbartin tërë vërtetësinë e jetës, do të bëhen shembull i fortë për edukimin komunist të masave, shembull frymëzimi për vepra të mëdha në dobi të shoqërisë.

3. Ta zhvillojmë karakterin novator të letërsisë dhe të artit tonë

Ne kemi krijuar një letërsi dhe art që, për vetë natyrën e tyre, janë novatorë, si shprehje të një epoke të re në historinë e popullit tonë e të njerëzimit. Për faktin se ata shënojnë një hap të madh përpara në krahasim me zhvillimin e pamjaftueshëm që kishin njohur më parë, karakteri i tyre novator paraqitet edhe më i theksuar, si në pasqyrimin e jashtëzakonshëm të përmbajtjes, ashtu edhe në pasurimin e jashtëzakonshëm të mjeteve artistike.

Shkrimtarët e artistët tanë, që kur nisën të vihen në rrugën e realizmit socialist, zbatuan parimin marksist-leninist të mbështetjes në traditat kombëtare e ndërkombëtare, të vështruara këto me syrin kritik dialektik, duke u mbështetur në çka tradita kishte të shëndoshë e që mund t'i shërbente kohës sonë, zhvillimit të letërsisë dhe të artit tonë socialist. Në se aty nga fillimi i viteve '60, nis të diskutohet tek ne me zjarr çështja e novatorizmit, kjo nuk ndodhi sepse letërsia dhe arti ynë, gjer atë kohë, nuk kishin qenë novatorë, por sepse, në këtë fazë pjekurie, kur duhej të bënin një hap edhe më të madh përpara, problemi i novatorizmit delte edhe më në pah. Ky problem merrte një rëndësi të veçantë edhe sepse revizionizmi hodhi rrënjë në letërsinë dhe artin sovjetik e të disa demokracive popullore, duke i mohuar karakterin novator letërsisë dhe artit socialist.

Në fazën e tanishme të thellimit të revolucionit tonë ideologjik e kultural, kur shtrohet çështja e një kthese të vërtetë në letërsinë dhe artet tona, problemi i novatorizmit zgjon një interes të theksuar aktual. Plenumi XV i Komitetit Qendror të Partisë e veçanërisht fjala e shokut Enver dhjetorin e kaluar kanë sjellë një kontribut të madh për trajtimin e sqarimin e këtij problemi, në rrethanat konkrete të zhvillimit të letërsisë e të artit tonë.

Problemi i novatorizmit nuk është problemi i ekskludimit të traditës, por i kapërcimit dialektik të saj. Është problemi i përkrijimit progresiv e revolucionar, simbas ligjit të madh të jetës, që asgjë nuk vjen nga hiçi dhe asgjë nuk mbetet në vend. Shoku Enver thotë: «Është gabim të kuptohet novatorizmi si luftë kundër traditës. Marksistë-leninistët mbajnë ndaj traditës një qëndrim dialektik».

Dy rreziqe njej procesi i marrëdhënjeve midis novatorizmit e traditës: rrezikun e mohimit të traditës, që, siç thotë shoku Enver, «të shpie në qëndrime metafizike, nihiliste», dhe që është pozita në të cilën ndodhen modernistët e artit borgjez e revizionist, dhe rrezikun e hyj-

nizimit të traditës, që është gjithashtu i dëmshëm, sepse «çon në konservatorizëm dhe në shkëputje nga realiteti».

Kur shtrojmë çështjen e novatorizmit, shtrojmë në të njëjtën kohë edhe çështjen e origjinalitetit të letërsisë e të artit, që nuk mund të sigurohet pa mbështetjen në tokën amtare, d.m.th. në traditën e vendit. Në Kongresin V të partisë, shoku Enver tha: «Mbështetja në këto tradita, të kultivuara dhe popullore, të së kaluarës dhe të kohës sonë, është një çështje me rëndësi të madhe, pa të cilën nuk mund të bëhet fjalë për krijimin e vlerave të vërteta letrare dhe artistike, për krijimin e origjinalitetit të kulturës dhe të letërsisë shqiptare, për respektimin dhe zbatimin në jetë të parimit marksist-leninist, që arti dhe kultura jonë të jenë socialiste nga përmbajtja dhe kombëtare nga forma».

Të mbështetemi në tokën amtare, për ne, do të thotë të mbështetemi së pari në realitetin socialist shqiptar, në kulturën e artin tonë socialist, pa harruar asgjë nga trashëgimi ynë i vjetër që mund t'i shërbejë së tashmes.

Arti pasqyron jetën dhe është novator, së pari, sepse pasqyron fenomenet e reja të jetës. Fenomenet e reja që duken e zhvillohen, brendia e re që fiton jeta shoqërore dhe psikika individuale, ja çfarë e sjell të renë dhe, në të njëjtën kohë, edhe kombëtarin, me tërë origjinalitetin e vet, në art, ja se ç'e ka ruajtur dhe e ka sjellë në radhë të parë shqipëtarësinë në artin e letërsisë tonë të realizmit socialist. Aftësia e talentit është që të diktojë tendencat e zhvillimit të realitetit, kapërcimin nga një stad në një stad më të ri, të mos e shkëpusë artificialisht të sotmen e jetës nga e djeshmja dhe e nesërmja, ta zbulojë e trajtojë jetën në zhvillimin e saj revolucionar. Këtu qëndron edhe lidhja me traditën, edhe kapërcimi dialektik i traditës. Vetëm duke ecur me hapin e kohës mund të mbështetemi drejt tek tradita, përndryshe biem në amulli.

Spekulohet kur, në emër të novatorizmit, bëhet fjalë vetëm për elementet e formës, si vargu, ngjyra, kompozimi etj. Spekulohet gjithashtu kur, në emër të traditës, bëhet fjalë vetëm për elemente të formës. Të dy herët, kemi po një qëndrim formalist, idealist. Nga njëra anë, nuk kuptohet sa duhet se zhvillimi i formës vjen më ngadalë se zhvillimi i përmbajtjes dhe se elementët formalë nuk mund të determinojnë për një novatorizëm të vërtetë; qëllon të rëndet pastaj pas formës, nënçmohen elementet e formës që arti dhe letërsia kombëtare i kanë krijuar e përpunuar me shekuj, në favor të elementeve të formës që marrën nga jashtë. Nga ana tjetër nuk kuptohet sa duhet se përmbajtja e re lufton doemos për formë të re, se ndryshimet e formës janë çfaqje të pashmangshme të depërtimit të përmbajtjes së re në art. Ndizen kështu biseda akademike, diskutohet pa fund, me ngutje dhe alarme pa vend, me tepërime nga të dyja anët. Harrohet, p.sh. se vargjet tradicionale janë një pasuri e paçmueshme, që do t'i shërbejë akoma për shumë e shumë kohë poezisë sonë, apo harrohet se edhe këto vargje doemos do të evoluojnë, duke fituar cilësi e mundësi të reja përmes realizimeve novatore të poezisë sonë. U mohohet vargjeve të lira e drejta e ekzistencës.

Problemin e novatorizmit duhet ta shohim në themel si një problem brendie dhe të mos harrojmë, nga ana tjetër, atë që thotë shoku Enver, se novatorizmi nuk është çështje «e eksperimenteve të artistëve të veçantë». Kjo ka rëndësi të theksohet, sepse jo vetëm e sidomos midis të rinjve, ushqehen iluzione novatorizmi, të cilat zakonisht lidhen me

ndonjë provë ose eksperimentim forme, por edhe sepse talentet qëllon të vuajnë nga një ego e tepëruar, që i shtyn ta shohin nga lart e ta përbuzin kontributin kolektiv, pa të cilin ata nuk mund të bëjnë. Ngre krye pastaj ai «un» prepotent, i cili arrin të dëmtojë si krijimet e tyre, si jetën letrare dhe artistike, ku rrezikon të ndizet lufta midis «të rinjsh e të vjetërsh», për «idola» të reja e të vjetra, krijohen grupime, që nuk i përshtaten shoqërisë sonë dhe moralit socialist. Kjo nuk mohon rolin e veçantë të talenteve, në veprat e të cilëve konkretizohet në mënyrë të shquar eksperiencia e përbashkët dhe kontributi vetiak.

* * *

Në përmendëm disa raste kur ndikimi revizionist mundi të pjellë vepra recidive dhe të nxitë tendencat formaliste. Ky ndikim, që është rrezik kryesor për artin socialist, nuk duhet të na bëjë aspak të nënvlef-tësojmë rrezikun tjetër, atë të rutinës e të incercisë konservatore, që i kundërvihet revolucionarizimit të krijimtarisë.

Shfaqjet antisocialiste në prag të Kongresit tonë të parë, karakteri-zoheshin nga mohimi i përpjekjes për krijimin në Shqipëri të një letërsie të realizmit socialist. Bëhej thirrje për «kthim» në metodat e vjetra të romantizmit e të realizmit borgjez. Ky «kthim» në të kaluarën, donte të thotë, së pari, kthim të letërsia e klerit reaksionar katolik e të pa-suesve të saj.

Një prej karakteristikave të asaj letërsie ishte idealizmi i jetës pa-triarkale të vendit, posaçërisht të malësive. Çmohet sot merita e Migjenit, i cili, në kohën e vet, me një koncept klasor revolucionar, tregoi reali-tetin e hidhur të gjendjes shoqërore të kohës në malësi, ku «apoteozave të zotave» u zinin vendin «apoteozat e misrit». Letërsia dhe arti ynë këtë traditë revolucionare e shpuri përpara, duke zbuluar disa prej kontradik-tave klasore të saj, p.sh. duke zbuluar rolin e bajraktarëve dhe të kleri-këve gjakpirës e antipatriotë, në kohët e hershme e gjer në kohën tonë, duke treguar se si lufta kundër zakoneve prapanike dhe kundër kanunit mbetet e ashpër në malësi, pa harruar të ekzaltojë vetitë dalluese të ka-rakterit burror të malësorit dhe patriotizmin e tij popullor.

Megjithatë, tendenca për të paraqitur «trimin» e «burrin» në përg-jithësi, duke mos e parë me syrin thellësisht kritik e klasor, u duk në disa vepra, veçanërisht të skenës, kur dramën me vlerë «Halili e Hajrija» (K. Jakova) e pasuan, gjer aty nga fillimi i viteve '60, drama të tjera, kryesisht historike dhe me temë nga koha e pushtimit turk, si «Nora» (A. Skanjeti), «Shtatë shaljanët» (N. Luca). «Trimi i mirë me shokë shumë» (S. Pitarka) etj., që, kush më shumë e kush më pak, i paguanin haraç patriarkalizmit e sillnin në krijimtari argumente të vjetra. Një fe-nomen të tillë e hasim diçka tani së fundi edhe në ndonjë vepër, që rrahu me sukses temën shoqërore, si «Fisheku në pajë» (F. Kraja). Është vënë në dukje efekti frenues i elementeve konservatore për zhvillimin e tendencës realiste në dramaturgjinë tonë. Këtë efekt e ka mbështetur edhe mënyra e vjetëruar e të vënit në skenë, me pozat e njohura dhe aparatit etnografik, me gjuhën që disaherë tingëllon arkaike.

Karakteristika të tilla të vjetra vazhdojmë t'i hasim edhe gjetiu në letërsinë e artin tonë. Ato nuk duhet t'i nënçmojmë si efekte kryesisht të jashtme. Te një poemë si «Garda kruetane» (K. Jakova), theksi ideoemocional i veprës, aq i afërt me poemat romantike dhe rapsoditë

e së kaluarës, pra ajo anë e brendisë, është bërë pengesë në trajtimin e temës historike përmes botëkuptimit tonë të ri.

Problemet shoqërore, që janë trajtuar shpesh nga proza jonë, lidhur me ambientet patriarkale dhe mikroborgjeze, si dhe me luftën kundër këtyre, kanë gjetur disa herë një trajtim të vjetër sentimentalist e melodramatik, p.sh. te novelat «Dashuria e Mimosës» (N. Jorgaqi) dhe «Ditë të gjelbërta» (G. Kongoli), në tregime autorësh të rinj, kryesisht të fillimit të viteve '60, që u dhanë për një farë kohe dhe mbas temash të vogla.

4. T'i afrojmë edhe më shumë letërsinë e artet tek masat dhe t'i vëmë edhe më mirë në shërbim të tyre

Letërsia dhe artet tona kanë fituar një karakter të gjerë demokratik, që i bën vërtet të afërta për masat. Në rrugën e revolucionarizimit të tyre më të shpejtë, duke u pasuruar me temën aktuale e duke u thelluar në realitetin socialist, ato duhet të afrohen edhe më shumë tek masat, të vihen edhe më mirë në shërbim të tyre. Po kjo arrihet në rast se niveli i tyre i përgjithshëm artistik rritet, ashtu si do të rritet e thellohet përmbajtja, në rast se ato bëhen më të përsosura e më të kapshme nga masat.

Ne jemi kundër atij mendimi, sipas të cilit vetëm njerëzit që kanë fituar të paktën kulturën e mesme mundet ta kuptojnë artin. Ky është një koncept antisocialist, që predikon aristokratizimin e artit e që u përshtatet borgjezëve dhe revizionistëve, të cilët, duke e shtypur mizorisht popullin, edhe në art veçohen prej tij. Poezinë moderniste, artin abstraksionist, muzikën konkrete etj. nuk i kanë qasur masat popullore, edhe kur këto e kanë fituar kulturën e mesme, por «i kuptojnë» një pakicë njerëzish, të cilët s'janë tjetër veçse ata që i prodhojnë, si dhe përfaqësuesit e shtresave të larta të borgjezisë e të intelektualëve reaksionarë, plus snobët, që nuk mungojnë në shoqërinë borgjeze dhe revizioniste. Popullit i destinohet ahëre ajo letërsi, pikturë, muzikë apo kinema, që synon ta ushqejë atë me ndjenjat e ulta, me apolitizmin, pesimizmin etj. në mënyrë që klasat shfrytëzuese të sundojnë më lehtë mbi masat e çorientuara. Shoku Enver, në Kongresin V të Partisë, tha: «Duhet një luftë e ashpër kundër konceptit intelektualist borgjez dhe reaksionar, se teoria, filozofia, shkenca e arti, janë të vështira dhe nuk mund të kapen nga masat se ato mund të kuptohen vetëm nga kuadrot dhe inteligjenca, se masat nuk kanë arritur nivelin e nevojshëm për t'i kuptuar ato!».

Niveli i përgjithshëm i letërsisë dhe i arteve tona ka nevojë të ngrihet, që të mund t'u përgjigjet mirë kërkesave të masave, të cilat, efektivisht, e kanë ngritur me ritme më të shpejta nivelin e tyre të përgjithshëm kultural. Të metat e mjeshtërisë që vihen re në krijimtarinë tonë letrare dhe artistike, duke nisur nga gjuha, ngjyra, kompozimi etj., kërkojnë një përpjekje më të ndjeshme për kualifikimin e krijimtarisë. Përpjekje duhet të bëjnë veçanërisht brezat e talenteve të reja, të cilët duhet të jenë më këmbëngulës në punën e tyre. Akoma shpesh në gazetën «Drita» dhe në revistën «Nendori» botohen vepra të nivelit të ulët, vjersha që përsërisin njëra-tjetrën, proza që të lënë indiferent,

kurse në këto organe duhet të gjejë vend edhe më shpesh ajka e asaj që shkruhet, në mënyrë që organet e shtypit të Lidhjes të bëhen nxitëse të një pune më mjeshtërore.

Dëgjojmë shpesh qarje të lexuesve ndaj poezisë, veçanërisht ndaj ngarkesave me figura të kërkuara, ndaj vargjeve pa ndonjë nuancë ritmi. Ka vjersha ku duhet të mbërthesh vëmendjen figurë mbas figure, kurse vargjet nuk të ngrejnë në valët e ritmeve të tyre. Tregëtuesit e librit, duke gjetur udhën më të lehtë, qëllon të propozojnë uljen e tirazheve. Ata thonë se «poezia nuk shitet». Në fakt, poezia lexohet më shumë nga ç'kujtojmë ne, lexohet në faqet e shtypit. Thuhet se «lexuesi nuk është mësuar me vargjet e lira». Në të vërtetë, disa nga sukseset e poezisë sonë të kësaj dekade, janë vepra të shkruara me ato vargje e që gjithashtu kanë pasur kërkesa të veçanta ndaj figurës. Pra s'e kanë fajin domosdo as figurat. Që lexuesit të afrohen më shumë nga poezia, është e nevojshme që poetët të gjejnë mënyrat e afrimit me masat, dhe ky është edhe një problem forme, problemi i trajtimit më mjeshtëror të vargut e të figurave. Çdo tendencë që mund ta çonte poezinë të prozaizmi dhe çdo tendencë që mund të ngjallte hermetizmin, do ta largonte poezinë nga masat.

Edhe vëllimet me tregime janë lexuar pak, më pak se romanet. Ndofta sepse edhe tregimi lexohet më me kënaqësi në një gazetë a revistë. Dhe fakt është se shtypi bëhet më tërheqës kur boton tregime. Po njihet mjeshtëria e veçantë që kërkon puna me tregimin, ku nuk ka vend për fjalë shumë. Pra edhe në një gjini të tillë, ku tanimë proza jonë ka një traditë që mund ta quash të fortë, puna me fjalën, sikundër dhe me kompozimin e personazhet, duhet të bëhet më e përkryer. Përpyekjet që kemi pasur këto vitet e fundit për një kapje më të ndryshme të temës nga ajo mënyra tradicionale e të rrëfyerit popullor dhe e tregimit klasik, janë një kontribut me vlerë për zhvillimin e gjinisë dhe kanë ngjallur edhe më shumë interes për të. Përpyekja që është bërë për zhvillimin e novelës dhe të romanit të shkurtër, e ka aftësuar edhe këtë pjesë të prozës për t'i u përgjegjur flakë për flakë realitetit, pra edhe për t'u afruar më shpejt me masat.

Probleme të veçanta e të rëndësishme ngre sot letërsia dhe arti ynë për fëmijët (muzika, ilustrimi i librit e i shtypit për të vegjëlit etj.). Një hap është bërë përse i takon sasisë dhe autorët janë shtuar. Përmbajtja është pasuruar dhe në qendër të saj është tema aktuale nga jeta e të vegjëlve. Sot trajtohen më shumë gjini dhe kanë nisur të duken gjinitë e gjata (novela, romani, tabloja kompozicionale, opereta etj.). Niveli artistik është ngritur. Megjithatë, si për nga sasia, ashtu edhe për nga larmia tematike dhe cilësia, jemi ende larg prej asaj që nevojitet. Letërsia dhe arti ynë për fëmijë vuajnë sidomos nga njohja e pakë e jetës së të vegjëlve dhe e psikologjisë së tyre. Ato vuajnë edhe nga një farë nënvlefësimi që ekziston për këtë sektor të artit e të letërsisë nga autorët, të cilët shpesh nuk luftojnë për një nivel të kënaqshëm artistik. Gjinitë fantastiko-shkencore gati nuk lërohen, kurse ekzistojnë keqkuptime për përrallën, e cila disaherë trajtohet në mënyrë mjaft të vjetër. Ekziston edhe opinioni i gabuar, sipas të cilit «përralla nuk i përshatet më kohës dhe e edukon keq fëmijin tonë». Është e domosdoshme që letërsia dhe arti ynë për fëmijë të fitojnë një përmbajtje më të thellë, më të pasur e më të larmishme, të lërojnë sa më shumë gjini dhe të shpien përpara gjinitë e gjata, me një përpyekje shumë më

serioze për ngritjen e nivelit të përgjithshëm artistik. Të bëhet këtu me një fjalë, po ajo kthesë që kërkohet edhe në sektorët e tjerë të krijimtarisë sonë. Edukimi revolucionar i të vegjëlve duhet të jetë një preokupim i madh i letrarëve dhe i artistëve, jo vetëm i atyre që merren posaçërisht me letërsinë dhe artin për fëmijë, por i gjithë kolektivit.

* * *

Posa që arti krijohet për masat, vlerësuesi më i drejtë i tij duhet të jetë gjithashtu opinionin i masave. Masat tona interesohen dita me ditë më shumë për jetën e artit. Zëri i tyre po fillon të ndjehet më fort për krijimet tona, me gjykimet e kërkesat e tyre. Andaj edhe ne, jo vetëm që duhet ta çmojmë në mënyrë më të plotë opinionin e masave, po veçanërisht të bëjmë që ky opinion, mbi veprat e veçanta dhe mbi krijimtarinë tonë në përgjithësi, të marrë udhë e të zhvillohet, të shfaqet dendur e më dendur, si në mbledhjet e takimet e organizuara, si në shtyp, e sidomos në shtypin letraro-artistik.

Kontrolli i klasës punëtore, që, pas fjalimit programatik të shokut Enver mbi këtë çështje, ka filluar të bëhet një normë e madhe e jetës sonë, do të ishte shfaqja më e lartë e interesit e e ndihmës së masave për artin e letërsinë. Ai kontroll do të sillte në jetën tonë letrare dhe artistike jo vetëm gjykimin e kërkesën e klasës pararojë, po bashkë me këtë, edhe shëmbullin e principialitetit revolucionar në kqyrjen e problemeve nga këndi i interesave të masave dhe të socializmit. Fryma e partishmërisë do të frynte kështu më e fortë në jetën tonë letrare dhe artistike.

Kritika jonë letrare dhe artistike është e para që do të fitojë nga zëri i masave. Kritika, në themel, duhet të sjellë këtë zë mbi letërsinë e artin, dhe duhet të mos kënaqet se e kreu detyrën e saj pa konsultuar opinionin e masave. Kritika, nga ana tjetër, u drejtohet masave për t'i ndihmuar ato në njohjen e veprave dhe të problemeve ideologjike e posaçërisht estetike, që veprat ngrejnë dhe që ngre jeta. Ne duhet ta hedhim poshtë atë mendim reaksionar, sipas të cilit masat nuk janë në gjendje të gjykojnë mbi letërsinë e artin apo të afrohen me problemet estetike.

Kritika jonë letrare dhe artistike ka bërë një hap përpara këto vjet, duke rrahur në mënyrë më kompetente disa probleme të krijimtarisë dhe duke e nxitur zhvillimin e mendimit teorik. Organet e shtypit të Lidhjes kanë lojtur një rol kryesor për këtë. Shokë shkrimtarë, artistë e kritikë si D. Siliqi, K. Bihiku, R. Brahim, D. Shapllor, K. Velça, A. Myftiu, A. Kallulli, A. Kuqali, A. Paparisto, Ç. Zadeja etj. kanë dhënë kontribut në zbërthimin e shumë çështjeve, ndonse jo në mënyrë sistematike. Prapë, kritika jonë mbetet sidomos regjionale. Ajo ka nevojë të gjallërohet, të jetë më militante e më parimore, më e thellë. Aty nuk duhet të gjejnë vend opinionet e prira nga simpatitë e antipatitë personale dhe nga shpirti egoistik, që janë çfaqur herë pas here, që janë të huaja për jetën tonë letrare dhe artistike. Kritika duhet të ndihmojë për krijimin e një atmosfere mobilizimi të madh krijues.

Gjallërimi i pakë i njerëzve tanë të krijimtarisë, që vihet re në diskutimet e organizuara, bie në sy edhe në faqet e kritikës. Arësye

e kësaj gjendjeje nuk është vetëm mungesa e guximit që rrjedh nga përgatitja e pamjaftueshme ideologjike, por edhe droja për të mos prishur qejf e për të mos u keqkuptuar. Opinione ka, por ato shfaqen sidomos në rrethe të ngushta, «midis shokësh», ku rrihen e diskutohen edhe me pasion. Çështja është pra, që ne të dalim prej kësaj guacke dhe mbledhjet e shtypi të bëhen tribuna, ku të zjejë mendimi krijues mbi artin, ku të shoshiten e të sqarohen opinionet, ku kritika të bëhet ai mjet i madh konstruktiv, pa të cilin edhe në art nuk shkohet përpara, pa të cilin nuk mund të thellohemi në problemet tona, nuk mund të korrigjojmë të metat e krijimtarisë, nuk mund të farkojmë një art me partishmëri të lartë komuniste, të pasur në ide, të përsosur në formë, plotësisht të denjë të popullit tonë heroik e të talentuar. Zbatimi i vijës së masave, edhe këtu, është rruga drejt revolucionarizimit.

